



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 447/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Vllastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të sulmit fizik dhe kërcënimit ndaj zyrtarëve në Malishevë, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Hidhet** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik PDK, me te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në fshatin Panroc në Malishevë, në oborrin e shkollës fillore “Asim Vokshi” ku ka qenë edhe Qendra e Votimit me nr. 30313/A, është sulmuar fizikisht Bali Rudi, në cilësinë e kryetarit të nëndegës së PDK-së, nga vëllezërit e nënkryetarit të degës së LDK-së Fetah Rudi. Në fshatin Carallukë komuna e Malishevës siç theksohet në ankesë është kërcënuar Burim Thaqi Thaqi, në cilësinë e kryetarit të komisionit në vendvotim nr30/36A/01R, nga përfaqësuesit e LDK-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ika bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Në raportin e Policisë të datës 12.12.2010, me nr.2010-GE-641, theksohet se fjalosja ka filluar në mes të Shaip Rudaj nga fshati Rud komuna e Malishevës dhe Bali Rudi nga fshati Rud komuna e Malishevës, për shkak se në ditën që LDK-ja kishte mbajtur fushatën zgjedhore në këtë fshat Shaip Rudaj i kishte rënë buris para dyerve të shtëpisë së Bali Rudit. Ndërsa sa i përket rastit në fshatin Caralluk në raport theksohet se menaxheri QV ka pasur një mosmarrëveshje mes komisioneve për vendosjen e tyre në vende por nuk ka pas ndonjë ankesë zyrtare që është drejtuar tek policia dhe që policia është dashtë të merret me rast sikur në rastin e sipërpërmendur.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**- ankesa është e palejuar**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet e bëra nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë, nuk janë të asaj natyre që PZAP mund të merr vendim për çështjen në fjalë ngase ngjarja ka ndodhur jashtë QV-së sipas raportit të Policisë i cili raport gjendet në shkresat e lendes.

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 447/2010 më datën 14.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxha**

